

1 E martë, 4 shkurt 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Vendimi mbi marrëveshjet për pranimin e
4 fajësisë]

5 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

6 --- Seanca fillon në orën 14.30

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Mirëmëngjes dhe mirë se keni ardhur, juve të pranishëm në
9 sallën e gjyqit, në publik dhe përmes videolidhjes.

10 Znj. Sekretare, thërrisni lëndën, ju lutem.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të
12 nderuar Gjykatës. kjo është çështja KSC-BC-2023-10, Prokurori
13 i Specializuar kundër Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe
14 Haxhi Shalës.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
16 do t'ju kërkoj palëve të prezantohen, duke filluar me Zyrën e
17 Prokurorit të Specializuar.

18 Fjalën e keni ju.

19 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Ulur afër
20 meje, pas meje është Ferdinand -- Ward Ferdinandusse,
21 Zëvendësprokurori i Specializuar; prapa meje në të majtë është
22 Line Pedersen, Menaxharja e çështjes; dhe në anën time të
23 majtë, John Devayne, Ndhmësprokuror; dhe unë Tazneed
24 Shahabuddin, Prokurore.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Tani do t'i drejtohem Mbrojtjes dhe do të doja që të
3 prezantoheni dhe të thuajni kush është i pranishëm në sallë
4 dhe kush merr pjesë përmes videolidhjes. E njëjta gjë dhe për
5 klientët tuaj.

6 Fillojmë me Mbrojtjen e z. Shala.

7 Z. CADMAN: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Mirëdita të
8 gjithëve. Unë marr pjesë përmes videolidhjes. Jam avokati i z.
9 Haxhi Shala, i cili është i pranishëm në seancën e gjyqit.
10 Gjithashtu me mua, përmes videolidhjes është edhe z. Jonathan
11 Rees [Sipas përkthimit].

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Mikrofoni
13 çaktivizuar].

14 [Përkthim] Tani i drejtohem Mbrojtjes së z. Januzi.

15 Z. REES: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Edhe unë jam
16 përmes videolidhjes. Përfaqësoj z. Januzi. Z. Huw Bowden,
17 bashkëmbrojtës, i pranishëm në sallën e gjyqit dhe Muharrem
18 Halilaj, i cili na ndihmon ne, asistenti i jonë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Tani i drejtohem Mbrojtjes së z. Bahtijari. Fjalën e keni
22 ju.

23 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Mirëdita të
24 gjithëve. Jam Felicity Gerry, Mbrojtëse e Specializuar e z.
25 Bahtijari. Marr pjesë përmes videolidhjes. Në sallën e gjyqit

1 është Marion Carrin, e cila është Bashkëmbrojtëse e
2 Specializuar dhe zyrtarja ligjore Youqing Liu. Z. Bahtijari
3 është i pranishëm në sallën e gjyqit.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Faleminderit.

6 Ne synojmë që ta mbajmë këtë seancë publike. Trupi
7 Gjykses ju kujton palëve se në rast se ka nevojë të kalojë në
8 seancë private, për shembull, për të respektuar privatësinë e
9 të akuzuarve apo për të shmangur nxjerrjen, zbulimin e ndonjë
10 informacioni konfidencial, më thuani dhe do të vendosim mbi
11 kërkesën tuaj sa më shpejt që të jetë e mundur.

12 Trupi Gjykses ka caktuar seancën e sotme për të vendosur
13 mbi marrëveshjet e fajësisë të arritura mes Zyrës së
14 Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtjes së Shalës, Mbrojtjes
15 së Januzit dhe Mbrojtjes së Bahtijarit, përkatësisht. Do të
16 nxjerrim arsyet me shkrim për aktvendimin e sotëm në kohën e
17 duhur.

18 Trupi Gjykses vëren se me 3 shkurt 2025, palët dorëzuan
19 parashtrimin lidhur me zhdëmtimet, kjo është parashtrimi i
20 protokolluar 669, Shtojca 1. Dhe, së pari, Trupi Gjykses do
21 t'ju kërkojë të akuzuarve që të pohojnë, të konfirmojnë
22 pëlqimin, marrëveshjen e tyre lidhur me zhdëmtimet, të
23 përfshira në parashtrimin në fjalë. Pastaj do të vendim lidhur
24 me marrëveshjet për pranimin e fajësisë për tre të akuzuarit.
25 Dhe në fund do të trajtojmë çështje që lidhen me to.

1 Përpara që të vazhdojmë me çështjet e marrëveshjes së
2 marrëveshjeve të fajësisë, Trupi Gjykues do të vendosë lidhur
3 me kërkesën e parashtruar nga Mbrojtja e Bahtijarit. Këtë do
4 ta bëjmë në seancë private.

5 Znj. Sekretare, na kaloni në seancë private, ju lutem.

6 [Seancë private]

7 [Seancë private teksti i fshirë]

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16 [Seancë e hapur]

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit, znj. Sekretare.

20 Tani do të vazhdojmë me seancën lidhur me zhdëmtimet.

21 Trupi Gjygues tani do t'ju kërkojë secilit prej të

22 akuzuarve të konfirmojnë pëlqimin e tyre lidhur me pranimin e

23 zhdëmtime që do t'ju jepen, Viktimës 01, siç përshkruar në

24 parashtrimin 661A01 [Sipas përkthimit] Shtojca 01.

25 Do filloj me ju z. Shala. A mund të konfirmoni që jeni

1 dakorduar për shumën prej 500 eurosh si zhdëmtim për Viktimën
2 01, dhe që pagesa do të bëhet si në vijim: Ju do të paguani
3 400 euro; Z. Januzi do të paguajë 100 euro; dhe z. Bahtijari
4 nuk do të paguajë asgjë.

5 Fjalën e keni juve.

6 I AKUZUARI SHALA: Po, e nderuar Gjykatëse.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit.

9 Tani i drejtohem z. Januzi.

10 Z. Januzi, a mund të konfirmoni që jeni dakorduar për
11 shumën prej 500 eurosh si zhdëmtim për Viktimën 1 dhe që
12 pagesa do të bëhet si në vijim: Z. Shala do të paguajë 400
13 euro; ju do të paguani 100 euro; dhe z. Bahtijari nuk do të
14 paguajë asgjë.

15 Fjalën e keni ju.

16 I AKUZUARI JANUZI: Po, dakord jemi.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Faleminderit.

19 Z. Bahtijari, a mund të konfirmoni që jeni dakorduar për
20 shumën prej 500 eurosh si zhdëmtim për Viktimën 1, dhe pagesa
21 do të bëhet si në vijim: Z. Shala do të paguajë 400 euro; z.
22 Januzi do të paguajë 100 euro; dhe ju nuk do të paguani asgjë.

23 Fjalën e keni ju.

24 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po, znj. Gjykatëse.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Për rrjedhojë, Trupi Gjykses vendos të shqyrtojë
3 parashtrimin 661, Shtojca 1, si shtesë e marrëveshjeve për
4 fajësinë dhe tani e tutje do t'i referohem kësaj si
5 "addendum", pra "Shtojcë e marrëveshjeve të fajësisë", në
6 tërësi së bashku "marrëveshjet për fajësinë".

7 Tani do të kaloj tek -- tani do të kaloj tek vendimi i
8 Trupit Gjykses sa i takon marrëveshjeve të fajësisë dhe
9 shtojcën për marrëveshjen e fajësisë.

10 Do të filloj me historikun procedural.

11 Më 13 nëntor 2024, ZPS-ja informoi Trupin Gjykses se
12 kishte arritur marrëveshje për fajësinë me z. Shala, z. Januzi
13 dhe z. Bahtijari, dhe ja bëri me dije këto marrëveshje Trupit
14 Gjykses. Për procesverbal, është parashtrimi i protokolluar
15 00596.

16 Me 6 dhjetor 2024, në pajtim me një vendim të Trupit
17 Gjykses ZPS-ja dorëzoi versionet e rishikuara të secilës prej
18 marrëveshjeve të fajësisë për z. Shala, është parashtrimi i
19 protokolluar 618A01, për z. Januzi është i njëjti numër
20 parashtrimi, por që përfundon me 02 - parashtrime të këtyre
21 marrëveshjeve dhe dënimet si dhe aktakuzën e rishikuar.

22 Me datë 16 dhjetor 2024, ZPS-ja informoi Trupin Gjykses
23 që kishte rënë dakord për një marrëveshje të re fajësie me z.
24 Bahtijari, dhe ja bëri me dije këtë marrëveshje Trupit
25 Gjykses. Ky është parashtrimi i protokolluar 628-01.

1 Më 17 dhjetor 2024, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e rishikuar
2 më tej që është parashtrimi 630, dhe me 17 dhjetor 2024 në
3 aktakuzën e kësaj data ZPS-ja tërhoqi një prej pikave të
4 aktakuzës së lidhur me pengimin e personave zyrtarë për
5 ushtrimin e detyrave të tyre zyrtare përmes kanosjeve të
6 rënda, që janë të ndëshkueshme sipas nenit 401(1) dhe (5) i
7 Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019 dhe neni 15(2) i Ligjit,
8 si dhe kanosje e rëndë për proceset penale sipas nenit 387
9 Kodit Penal të Kosovës të 2019-s.

10 Me datë 18 dhe 19 dhjetor 2024, Trupi Gjykses organizoi
11 seanca për marrëveshjet për pranimin e fajësisë për të tri të
12 akuzuarit.

13 Më 29 janar 2025, pas dorëzimit të një raporti të Zyrës
14 për Pjesëmarrjen e Viktimave dhe parashtrimet përkatëse të
15 palëve, në pajtim me urdhrin gojor të Trupit Gjykses datë 18
16 dhjetor 2024, Trupi Gjykses vendosi që të pranonte një kërkues
17 si viktimë për të marrë pjesë në procesin gjyqësor, që është
18 Viktima 1, dhe u kërkoi palëve të dorëzonin versionet e
19 rishikuara të marrëveshjeve përkatëse për pranimin e fajësisë
20 me propozime për zhdëmtime për sa i takon viktimës në këtë
21 rast, pra që është Viktima 1. Dhe gjithashtu caktoi seancën e
22 ditës së sotme për sa i takon vendimit për marrëveshjen e
23 fajësisë, që është parashtrimi 667 RED.

24 Më 3 shkurt 2025, domethënë, dje, në pajtim me vendimin e
25 datës 29 janar 2025, palët bashkërisht dorëzuan shtojcën në

1 marrëveshjet e pranimi të fajësisë, që është parashtimi 669,
2 Shtoja 1, sikurse e thashë dhe më herët.

3 Tani t'i kthehem vendimmarrjes nga Trupi Gjykses.

4 Trupi Gjykses bindet në fillim në fillim që sikurse
5 kërkohet rregullës 94(2) i Rregullores, secila prej
6 marrëveshjeve për pranimin e fajësisë përmban një marrëveshje
7 midis ZPS-së dhe ekipeve të Mbrojtjes lidhur me akuzat të
8 cilat përfshijnë pjesëmarrjen e të akuzuarit në veprat penale
9 të akuzuara në aktakuzë dhe mënyrat, format e përgjegjësisë
10 penale; një dënim konkret; si dhe zhdëmtim për viktimën që
11 merr pjesë në këtë proces.

12 Sa i takon aktakuzave në aktakuzë, secili prej të
13 akuzuarve është pajtuar sa i takon pranimi të fajësisë në
14 lidhje me një të një prej pikave të pengimit të personave zyrtarë
15 në kryerjen e detyrave zyrtare duke marrë pjesë në veprime të
16 përbashkëta të një grupi, dhe një pikë të kërcënimit gjatë
17 procesit penal. Secili prej të akuzuarve është deklaruar
18 fajtor për këto pika gjatë seancave të organizuara me datë 18
19 dhe 19 dhjetor 2024.

20 ZPS-ja dhe secili prej të akuzuarve kanë rënë dakord
21 lidhur me faktet e mëposhtme sikurse ato pasqyrohen në një
22 shtojcë të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë.

23 Secili prej të akuzuarve pranon se ka qenë pjesë e një
24 grupi që është përpjekur që të nxisë Dëshmitarin 1 që të
25 shmanget nga dhënia e dëshmimeve përpara Dhomave të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Vendimi mbi marrëveshjet për pranimin e fajësisë (Seancë e hapur) Faqe 13

1 Specializuara të Kosovës përmes premtimit të një përfitimi. Në
2 veçanti, z. Januzi dhe z. Bahtijari, duke vepruar nën
3 udhëzimet e z. Shala janë takuar me dëshmitarin në shtëpinë e
4 vet me datë 5 dhe 12 prill 2023.

5 Gjatë kontaktit apo takimit të datës 5 prill 2023, z.
6 Bahtijari i ka thënë dëshmitarit se ai duhej që të tërheqë
7 dëshminë e tij përpara Dhomave të Specializuara të Kosovës.

8 Gjatë takimit më 12 prill 2023, z. Januzi ka pasuar
9 takimin e parë me dëshmitarin dhe i ka thënë dëshmitarit një -
10 - i ka dhënë atij një ofertë, që z. Shala dhe të tjerët do ta
11 ndihmonin atë në rast se ai do të tërhiqte dëshminë e dhënë.

12 Z. Shala dhe z. Januzi kanë komunikuar dhe janë
13 koordinuar me njëri-tjetrin sa i takon ndërveprimeve të tyre
14 me dëshmitarin përpara dhe pas secilit prej dy takime,
15 domethënë, takimeve të datës 5 dhe 12 prill 2023. Z. Bahtijari
16 ka komunikuar, është bashkërenduar me z. Shala dhe z. Januzi
17 sa i takon ndërveprimeve me dëshmitarin përpara dhe pas
18 takimit me dëshmitarin me datë 5 prill 2023 dhe përpara
19 takimit me datë 12 prill 2023.

20 Sa i takon dënimeve, z. Shala pajtohet me vendosjen e një
21 dënimi me burgim për 3 vjet; z. Januzi pajtohet me vendosjen e
22 dënimit nga 24 muaj deri në 30 muaj; z. Bahtijari, po ashtu
23 pajtohet me vendosjen e një dënimi për dy vjet burgim.

24 Sa i takon zhdëmtimeve, të akuzuarit janë pajtuar që të
25 paguajnë shumën e përgjithshme të 500 eurove për Viktimën 1,

1 sikurse specifikohet në shtojcën e marrëveshjeve për pranimin
2 e fajësisë.

3 Trupi Gjykses më tej bindet se, sikurse kërkohet sipas
4 rregullës 94(5) i Rregullores, dhe sikurse është verifikuar
5 gjatë seancave të datave 18 dhe 19 dhjetor 2023 -- të 2024,
6 dhe sot gjatë seancës së parë, pra, parapa sesa të vinim në
7 këtë pikë, secili prej ekipeve të Mbrojtjes e ka diskutuar
8 kushtet e marrëveshjeve për pranimin e fajësisë me klientët e
9 tyre, që z. Shala, z. Januzi dhe z. Bahtijari i kuptojnë
10 kushtet e marrëveshjeve përkatëse për pranimin e fajësisë, që
11 z. Shala, z. Januzi dhe z. Bahtijari pranojnë faktet në lidhje
12 me akuzat e përfshira në marrëveshjet përkatëse të tyre për
13 pranimin e fajësisë dhe janë pajtuar me marrëveshjet për
14 pranimin e fajësisë në mënyrë vullnetare pa kërcënime dhe pa
15 shtrëngime. Z. Shala, z. Januzi dhe z. Bahtijari, i kuptojnë
16 pasojat e marrëveshjeve përkatëse për pranimin e fajësisë dhe
17 heqin dorë nga e drejta e tyre që të gjykohen në një procedurë
18 të zakonshme gjykimit.

19 Trupi Gjykses, po ashtu, është bindur se mjafton ose ka
20 një bazë të mjaftueshme faktike që vërteton faktet thelbësore
21 që janë të nevojshme për të provuar krimin dhe pjesëmarrjen e
22 të akuzuarve.

23 Dhe Trupi Gjykses, në fund, bindet se interesat e
24 drejtësisë janë marrë siç duhet parasysh.

25 Për rrjedhojë, Trupi Gjykses vendos, në pajtim me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Vendimi mbi marrëveshjet për pranimin e fajësisë (Seancë e hapur) Faqe 15

1 rregullën 94 të Rregullores, që të miratojë marrëveshjet për
2 pranimin e fajësisë për të tre të akuzuarit, për z. Shala, z.
3 Januzi dhe z. Bahtijari.

4 Ju lutem, të treve të ngriheni në këmbë.

5 Në emër të popullit të Kosovës, Trupi Gjykues, ju
6 konstaton ju z. Shala, z. Januzi dhe z. Bahtijari, fajtorë për
7 veprat e mëposhtme në bazë të Pikave 1 dhe 2 të Aktakuzës së
8 datës 17 dhjetor 2024, që është parashtrimi i protokolluar
9 631, Shtojca 1. Këto janë:

10 Pengimi i personave zyrtarë për kryerjen e detyrave
11 zyrtare përmes pjesëmarrjes të veprimit të përbashkët në një
12 grup, të kryer ndërmjet periudhës, së paku 5 deri 12 prill
13 2023, në pajtim me nenet 17, 21, 401(2) dhe (5) të Kodit Penal
14 të Kosovës të vitit 2019, dhe nenet 15(2) dhe 16(3) i Ligjit;
15 dhe për frikësim gjatë proceseve penale, të kryera ndërmjet,
16 së paku 5 dhe 12 prillit 2023, në pajtim me nenet 21, 31 dhe
17 387 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, dhe nenet 15(2)
18 dhe 16(3) i ligjit.

19 Pasi konstatuar fajësinë e të akuzuarve nën Pikat 1 dhe 2
20 të Aktakuzës të datës 17 dhjetor 2024, Trupi Gjykues tani do
21 të vazhdojë me dënimin.

22 Pasi ka shqyrtuar argumentet dhe provat e paraqitura nga
23 palët, Trupi Gjykues lëshon këto dënime, z. Haxhi Shala
24 dënohet me tre vite burgim; z. Sabit Januzi dënohet me dy vite
25 burgim; dhe z. Ismet Bahtijari dënohet me dy vite burgim.

1 Mund të uleni.

2 Sa i takon kohës së llogaritur për atë çfarë është
3 shpenzuar deri tani, Trupi Gjykses vëren se z. Bahtijari dhe
4 z. Januzi janë arrestuar me datën 5 tetor 2023 dhe të dy janë
5 ndaluar në ambientet e paraburgimit të Dhomave të
6 Specializuara të Kosovës që prej datës 6 tetor 2023. Trupi
7 Gjykses, për rrjedhojë, e zbret kohën e atë akuzuarve që kanë
8 shpenzuar në objektin e paraburgimit që prej 5 tetorit 2023.

9 Sa i takon z. Shala, Trupi Gjykses vëren se ai është
10 arrestuar me datë 11 dhjetor 2023 dhe ka qenë i ndaluar në
11 ambientet e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të
12 Kosovës, që prej datës 12 dhjetor 2023. Për rrjedhojë Trupi
13 Gjykses e zbret kohën e shpenzuar prej tij në ambientet e
14 paraburgimit që prej 11 dhjetorit 2023.

15 Sa i takon zhdëmtimeve, të akuzuarit do të paguajnë
16 shumën e përgjithshme prej 500 eurosh për Viktimën 1. Pagesat
17 do të bëhen si më poshtë: z. Shala do të paguajë 400 euro; z.
18 Januzi do të paguajë 100 euro; dhe z. Bahtijari nuk do të
19 paguajë asgjë.

20 Pagimet e këtyre shumave do të bëhen jo më vonë sesa të
21 mërkurën, datë 19 shkurt 2025 dhe për këtë arsye Zyra
22 Administrative është udhëzuar që të caktojë një llogari
23 bankare dhe të informojë të akuzuarit, pra, z. Shala dhe z.
24 Januzi përkohësisht se si do të bëjnë pagesat përkatëse.

25 Zyra Administrative në këtë aspekt mund të udhëzohet prej

1 Zyrës Administrative, pra mund t'i ofrohet mbështetja e
2 nevojshme Mbrojtjes së Viktimës në qoftë se do të jetë e
3 nevojshme.

4 Trupi Gjykses thekson se duhet që të konfirmojë deri me
5 datë 19 shkurt në qoftë se pagesat janë kryer në llogarinë
6 bankare përkatëse të Viktimës 1.

7 Trupi Gjykses nënvizon se në pajtim me 94(8) i
8 Rregullores, vendimi i Trupit Gjykses për marrëveshjen për
9 pranimin e fajësisë, ka forcën dhe efektin e një akti
10 përfundimtar gjyqësor dhe do të jetë objekt i rihapjes së një
11 procedure penale vetëm në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe
12 rregullës 187 të Rregullores.

13 Trupi Gjykses, thekson më tej që pas vuajtjes së dy të
14 tretave të dënimit, personi i burgosur ka të drejtë që t'i
15 nënshtrohet procedurës së parashikuar në nenin 51(2) i Ligjit
16 dhe kreun 12 të Rregullores.

17 Tani do të vazhdoj më tej me çështje të tjera.

18 Sikurse është thënë edhe më herët, Trupi Gjykses do të
19 japë arsyet me shkrim të vendimeve të ditës së sotme në
20 momentin e përshtatshëm. Trupi Gjykses vëren që përderisa z.
21 Shala, z. Januzi dhe z. Bahtijari janë dënuar sot në mënyrë
22 përfundimtare, nuk do të bëhet asnjë vendim tjetër që ka të
23 bëjë me rishikimin e paraburgimit, dhe si rezultat të gjitha
24 çështjet e tjera për planifikimin e seancave janë përfunduar.

25 Për më tepër, të gjitha kërkesat që do të citoj tani janë

1 tejkalluar për shkak të vendimit të marrë sot. Flitet për
2 parashtrimin e protokolluar F00287, 507, 519, 524, 529, 532
3 dhe 585.

4 Gjithashtu, Trupi Gjykues vendos që të mbajë
5 juridiksionin për të gjitha qëllimet e tjera të nevojshme për
6 këtë lëndë gjyqësore.

7 Në veçanti, Trupi Gjykues do të vendosë në momentin e
8 përshtatshëm lidhur me parashtrimin e protokolluar me numër 516
9 dhe 518.

10 Ky është fundi i seancës së ditës së sotme.

11 Falënderoj palët për pjesëmarrjen, gjithashtu dëshiroj që
12 të falënderoj përkthyerit, stenografët, teknikienët e audios
13 dhe videos si dhe personelin e sigurisë për ditën e sotme dhe
14 gjithë ndihmën e tyre.

15 Këtu mbyllet seanca e ditës së sotme.

16 --- Seanca mbyllet në orën 15.03

17

18

19

20

21

22

23

24

25